

DHJETOR 2025

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Dhjetor 2025

© Ministria e Financave, 2025

Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

**E-mail:** [Rei.Qerimi@financa.gov.al](mailto:Rei.Qerimi@financa.gov.al), [Elkejdo.Pacani@financa.gov.al](mailto:Elkejdo.Pacani@financa.gov.al)

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** \_\_\_\_\_ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** \_\_\_\_\_ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit \_\_\_\_\_ 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit \_\_\_\_\_ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave \_\_\_\_\_ 5
4. Bilanci i Pagesave \_\_\_\_\_ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar \_\_\_\_\_ 7
6. Kredia për Ekonominë \_\_\_\_\_ 8
7. Oferta e Parasë \_\_\_\_\_ 9
8. Depozitat sipas Burimeve \_\_\_\_\_ 10

**SEKTORI FISKAL** \_\_\_\_\_ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar \_\_\_\_\_ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve \_\_\_\_\_ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal \_\_\_\_\_ 12

**ANEKSI STATISTIKOR** \_\_\_\_\_ **13**

# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit, në dhjetor 2025, arriti në 120.92. Norma vjetore e inflacionit për muajin dhjetor 2025 ishte 2.3 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin dhjetor 2025 ishte 82.42 lekë për dollarë dhe 96.54 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit dhjetor 2025 shënuan normën 1.58 dhe 2.12 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit dhjetor 2025 shënuan normën 5.98 dhe 5.83 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,967,624 milionë lekë në muajin dhjetor 2025, duke shënuar një rritje prej rreth 10.2 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë 2025 rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 507.1 milionë euro;
- Situata buxhetore për periudhën janar-dhjetor 2025 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 47.1 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej 61.6 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-dhjetor 2025 arritën në rreth 754.6 miliardë lekë, ose afërsisht 6.2 përqind më shumë se periudha janar-dhjetor 2024 dhe 98 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë arritën në rreth 801.7 miliardë lekë, ose rreth 10.0 përqind më shumë se periudha janar-dhjetor 2024 dhe 96.4 përqind realizim kundrejt planit të periudhës.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Inflacioni vjetor për muajin dhjetor 2025 shënoi normën 2.3%, duke reflektuar një rritje të lehtë në krahasim me një vit më parë kur ky ndryshim ishte 2.1%. Ndryshimi mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin dhjetor 2025, krahasuar me një muaj më parë, ka shënuar rritje me 0.7%. Inflacioni mesatar për periudhën janar-dhjetor 2025 është 2.2%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

“Ushqime dhe pije joalkoolike” me rritje vjetore të çmimit prej +1.6%, duke kontribuar me +0.56 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.96 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +2.1%, duke kontribuar me +0.16 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.



“Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.11 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Mallra dhe shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +1.9%, duke kontribuar me +0.10 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Veshje dhe këpucë” me rritje vjetore të çmimit prej +0.4%, duke kontribuar me +0.02 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +2.6%, duke kontribuar me +0.15 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

Tab - 1	Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)												
VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
<b>2024</b>	3.4	2.6	2.3	2.1	2.2	2.1	2.1	2.0	1.9	1.9	2.0	<b>2.1</b>	
<b>2025</b>	2.0	1.9	2.1	2.3	2.2	2.4	2.5	2.3	2.4	2.3	2.1	<b>2.3</b>	

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin dhjetor 2025 arriti në 96.54 lekë/euro, duke u ulur me 0.12 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit dhjetor, një euro u këmbye me 96.77 lekë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 kundrejt dhjetor 2024, vihet re një mbiçmim i lehtë i lekut ndaj euros në 0.5 përqind.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin dhjetor 2025 arriti në 82.42 lekë/dollarë, duke shënuar rënie me 1.46 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit dhjetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 82.46 lekë/dollarë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 kundrejt dhjetor 2024, vihet re një mbiçmim i lekut ndaj dollarit në 7.5 përqind.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan shënoi një nivel mesatar rreth 0.85 dollarë/euro për muajin dhjetor 2025.


Në krahasim me muajin dhjetor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 1.79 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 12.22 përqind.

Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit u rishfaqën prej fundit të muajit prill, por ato paraqiten më të moderuara krahasuar me dy vitet e mëparshme. Presionet inflacioniste të brendshme mbetën të qëndrueshme duke treguar aktivitet ekonomik pranë potencialit, ndërsa presionet nga jashtë janë të dobëta, për shkak të një kursi të mbiçmuar të Lekut dhe rënies së inflacionit tek partnerët tregtarë. Forcimi i Lekut këtë vit ka qenë më i vonuar dhe më i përmbajtur, ndërkohë që tregu valutor është karakterizuar nga një luhatshmëri e ulët.




### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit dhjetor 2025, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan përkatësisht normat prej 1.58 dhe 2.12 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve janë ulur me 0.02 pikë përqindje, ndërsa për Korporatat jofinanciare janë ulur me 0.16 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rënie me 0.04 pikë përqindje dhe nuk kanë pasur ndryshim për Korporatat jofinanciare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12-mujore, për muajin dhjetor 2025, kanë shënuar normën 2.44 përqind, nga 2.72 përqind që shënonte të njëjtën periudhë një vit më parë. Norma e bonos 12-mujore u ul me 0.05 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe me 0.28 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Gjatë muajit dhjetor 2025, normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan normën 5.98 dhe 5.83 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas Individëve u ulën me 0.22 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit sipas Korporatave jofinanciare u ulën me 0.60 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të huave kanë shënuar rritje me 0.25 pikë përqindje për Individët dhe rënie me 0.49 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.





## 4. Bilanci i Pagesave T3-2025

Në tremujorin e tretë të vitit 2025, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, me rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 507 milionë euro, nga -367 milionë euro që ishte në tremujorin e tretë 2024.

Llogaria korrente u mbyll me balancë pozitive prej rreth 658 milionë euro, zgjeruar në terma vjetorë me rreth 311 milionë euro. Zgjerimi i suficitit në shërbime mbetet faktori përcaktues i këtij rezultati. Llogaria financiare dhe kapitale rezultoi në fluks neto dalës prej rreth 226 milionë euro, krahasuar me -94 milionë euro në tremujorin e tretë 2024.

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 449 milionë euro ose +10.4 përqind më shumë, krahasuar me +406 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2024. Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 285 milionë euro, ose +8.5 përqind, krahasuar me +262 milionë euro në tremujorin e tretë 2024.

Gjatë tremujorit të tretë 2025, mjetet e rezervës u zgjeruan me 507 milionë euro. Stoku i rezervës valutore, në fund të tremujorit të tretë 2025, shënon vlerën prej 7,269 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 11.7 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.





## 5. Mjetet Valutare Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit dhjetor 2025, sistemi bankar ka shënuar vlerën prej rreth 1,125,009 milionë lekë të mjeteve valutore neto (M.V.N), duke u rritur me rreth 108,148 milionë lekë krahasuar me muajin dhjetor 2024. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën Qendrore me 94,457 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 23,097 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 23,527 milionë lekë në Bankën Qendrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,967,624 milionë lekë në muajin dhjetor 2025, duke shënuar një rritje prej 182,377 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 10.2 përqind.

Në muajin dhjetor, sistemi bankar rezultoi me rritje mujore prej 47,393 milionë lekë, ose 2.5 përqind më shumë krahasuar me muajin nëntor 2025.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë në muajin dhjetor 2025 arriti në rreth 943,475 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 107,658 milionë lekë, ose rritje me rreth 12.9 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (58.9%) dhe monedhave të huaja (41.1%).


Gjatë muajit dhjetor 2025, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 54.8 përqind ose 516,591 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për Individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin rreth 41.0 përqind ose rreth 387,053 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.0 dhe 2.2 përqind, ose 18,999 dhe 20,820 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin dhjetor 2025, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 73.8 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 22.3 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.2 dhe 1.7 përqind secili.




## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 483,447 milionë lekë në fund të muajit dhjetor 2025. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në dhjetor 2025 ka shënuar një rritje mujore prej 0.23 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.85 pikë përqindje, duke arritur nivelin 24.6 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.40 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 1.47 pikë përqindje, duke shënuar nivelin 32.6 përqind.



Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin dhjetor 2025, kanë shënuar rritje vjetore prej rreth 41,115 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për Individë, të cilat përbëjnë rreth 73.8 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë, gjatë muajit dhjetor 2025, shënuan rritje prej 81,361 milionë lekë në krahasim me muajin dhjetor 2024. Sektori i Individëve në Lekë ka zënë 75.6 përqind të depozitave në lekë.





Në muajin dhjetor 2025, depozitat totale përbëjnë 75.4 përqind të agregatit M3, me një rënie rreth 0.85 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit dhjetor 2025, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 75.6 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 17.7 përqind dhe nga “Korporata jofinanciare publike” me 4.4 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.8 përqind dhe rreth 23.1 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 74.7 përqind të totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 1,108,142 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (304,213 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (39,350 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (26,004 milionë lekë) dhe “Qeveria lokale” me rreth 6,468 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit dhjetor 2025, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,484,177 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, niveli i depozitave shënoi rritje me rreth 31,344 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, totali i depozitave ka shënuar rritje me 122,476 milionë lekë.




# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-dhjetor 2025 janë mbledhur rreth 754.6 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej rreth 801.7 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 653.5 miliardë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat rreth 270.3 miliardë lekë shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pa përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dhe Doganave është rreth 496.2 miliardë lekë (99.3% realizim kundrejt planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 40.9 miliardë lekë (ose 0.3% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 179.1 miliardë lekë (ose 0.8% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 30.9 miliardë lekë (ose 97.5% realizim kundrejt planit të periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 653.5 miliardë lekë, 125.7 miliardë lekë (19.2% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 54.7 miliardë lekë (8.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 83.7 miliardë lekë (12.8% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 2.4 miliardë lekë (0.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 270.3 miliardë lekë (41.4%) për shpenzime për fonde speciale, 87.8 miliardë lekë (13.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 29.0 miliardë lekë (4.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

Shpenzimet kapitale për periudhën janar-dhjetor 2025 janë realizuar në masën 131.6 miliardë lekë.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-dhjetor 2025 ishin rreth 754.6 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 716.3 miliardë lekë, të ardhurat jotatimore në rreth 30.9 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat tatimore gjatë muajit Dhjetor 2025 (mln Lekë)

Emërtimi	Dhjetor'25	Dhjetor'24	Dhjetor'25/ Dhjetor'24 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	227,261	213,999	6.2
Tatimi mbi Fitimin	58,547	56,994	2.7
Akcizat	69,599	63,437	9.7
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	82,532	66,141	24.8
Taksa Nacionale dhe të tjera	48,799	47,419	2.9
Taksa Doganore	9,486	8,973	5.7

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Shkurt 2026

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për periudhën janar-dhjetor 2025 shënoi një deficit prej rreth 47.1 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej 61.6 miliardë lekë. Deficiti prej 47.1 miliardë lekë u financua kryesisht nga huamarrja e brendshme prej 38.8 miliardë lekë si dhe 8.2 miliardë lekë financim i huaj.

Për periudhën janar-dhjetor 2025, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 754.6 miliardë lekë;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 801.7 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën janar-dhjetor 2025, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 716.3 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 653.5 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 270.3 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2021	2022	2023	2024	2025	2021	2022	2023	2024	2025	2021	2022	2023	2024	2025	
Janar	1.3	1.3	1.1	0.5	0.4	1.3	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	3.7	7.2	3.4	2.0	January
Shkurt	1.1	1.3	1.1	0.3	0.3	1.2	1.3	1.1	0.4	0.4	1.1	3.9	7.1	2.6	1.9	February
Mars	0.7	2.4	0.7	0.4	0.6	1.0	1.7	1.0	0.4	0.4	1.2	5.7	5.3	2.3	2.1	March
Prill	0.2	0.7	0.0	-0.2	0.1	0.8	1.4	0.9	0.3	0.4	1.9	6.2	4.6	2.1	2.3	April
Maj	-0.9	-0.5	-0.3	-0.2	-0.3	0.5	1.0	0.7	0.2	0.2	1.8	6.7	4.7	2.2	2.2	May
Qershor	-0.8	-0.1	-0.3	-0.4	-0.2	0.3	0.9	0.6	0.3	0.2	1.6	7.4	4.5	2.1	2.4	June
Korrik	0.1	0.2	-0.1	-0.2	-0.1	0.2	0.8	0.5	0.2	0.1	2.2	7.5	4.2	2.1	2.5	July
Gusht	0.4	0.8	0.6	0.5	0.3	0.3	0.8	0.5	0.2	0.1	2.4	8.0	4.0	2.0	2.3	August
Shtator	0.5	0.6	0.7	0.6	0.7	0.3	0.7	0.4	0.1	0.2	2.5	8.1	4.1	1.9	2.4	September
Tetor	0.1	0.4	0.1	0.1	0.1	0.3	0.7	0.4	0.1	0.2	2.4	8.3	3.8	1.9	2.3	October
Nëntor	0.2	-0.3	-0.2	0.0	-0.2	0.3	0.6	0.3	0.1	0.2	3.1	7.9	3.9	2.0	2.1	November
Dhjetor	0.8	0.4	0.5	0.6	<b>0.7</b>	0.3	0.6	0.3	0.2	<b>0.2</b>	3.7	7.4	4.0	2.1	<b>2.3</b>	December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2025																Currency
	2021	2022	2023	2024	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
<b>Mesatarja e periudhës</b>																	<b>Average of period</b>
USD	103.68	113.04	100.65	93.09	95.09	95.10	91.90	88.33	86.97	85.11	83.62	83.66	82.70	83.10	83.64	82.42	USD
EURO	122.37	118.98	108.80	100.71	98.51	99.03	99.23	99.07	98.21	98.07	97.72	97.29	97.07	96.74	96.66	96.54	EURO
<b>Fundi i periudhës</b>																	<b>In the end of period</b>
USD	106.54	107.05	93.94	94.26	96.14	95.41	92.15	86.78	86.86	83.67	85.21	83.85	82.41	83.69	83.48	82.46	USD
EURO	120.76	114.23	103.88	98.15	99.80	99.23	99.29	98.71	98.39	98.08	97.47	97.88	96.82	96.83	96.70	96.77	EURO
<b>Burimi : Banka e Shqipërisë</b>																	<b>Source : Bank of Albania</b>
USD	mesatarja e periudhes				95.09	95.10	94.03	92.61	91.48	90.42	89.45	88.72	88.05	87.56	87.20	86.80	USD
EURO	mesatarja e periudhes				98.51	98.77	98.92	98.96	98.81	98.69	98.55	98.39	98.24	98.09	97.96	97.84	EURO
USD	mbicim/nencim krahasuar me dhjetor 2024				1.3%	1.3%	0.1%	-1.4%	-2.6%	-3.7%	-4.7%	-5.5%	-6.2%	-6.7%	-7.1%	-7.5%	USD
EURO	mbicim/nencim krahasuar me dhjetor 2024				0.2%	0.5%	0.6%	0.7%	0.5%	0.4%	0.3%	0.1%	-0.1%	-0.2%	-0.3%	-0.5%	EURO

Tab - 3

## Normat e Interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2025 Janar	2025 Shkurt	2025 Mars	2025 Prill	2025 Maj	2025 Qershor	2025 Korrik	2025 Gusht	2025 Shtator	2025 Tetor	2025 Nëntor	2025 Dhjetor	In percent
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December	
<b>Norma e Interesit të depozitave për individët</b>													<b>Interest rates on households deposits</b>
Deri në 1 vit	1.30	1.26	1.25	1.20	1.22	1.25	1.28	1.26	1.32	1.25	1.33	1.27	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.47	2.29	1.78	2.27	2.03	1.99	2.02	1.95	2.07	2.22	1.83	1.71	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.67	2.57	2.66	2.26	2.56	2.57	2.43	2.59	2.59	2.42	2.40	2.47	Over 2 years
<b>Norma e interesit të depozitave për korporatat jofinanciare</b>													<b>Interest rates on nonfinancial corporations deposits</b>
Deri në 1 vit	2.46	2.35	2.28	2.76	2.34	2.27	2.34	2.26	2.14	2.52	2.28	2.12	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.97	3.09	3.20	3.29	3.29	2.63	2.27	3.05	3.30	2.76	2.35	2.76	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	3.20	2.16	3.75	2.72	3.12	1.78	3.19	2.81	2.81	2.87	3.05	1.74	Over 2 years
<b>Normat e interesit të kredive për individët</b>													<b>Interest rates on household loans</b>
Kredi për banesa	3.58	3.82	3.64	3.82	3.85	3.84	3.76	3.94	3.93	4.01	3.84	3.73	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.21	7.96	8.54	8.83	8.87	8.88	9.16	8.35	8.04	8.44	8.80	8.71	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	8.46	11.21	10.71	10.53	9.34	8.58	8.86	7.85	9.18	9.58	10.89	7.54	Credit for other purposes
<b>Normat e Interesit të kredive për korporatat jofinanciare</b>													<b>Interest rates on nonfinancial corporations loans</b>
Kredi deri në 140 milionë lekë	6.89	6.81	6.67	6.69	6.68	6.65	6.65	6.21	6.42	6.32	6.33	5.87	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	5.92	6.35	5.52	7.45	6.56	6.44	6.99	5.90	6.77	7.21	6.54	5.78	Loans over an amount of 140 millions of lek
<b>Norma e letrave me vlerë</b>													<b>Securities rates</b>
Bono thesari 1/													Treasury bills 1/
3-M	-	2.60	-	-	2.60	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	-	-	2.63	-	-	2.62	-	-	-	-	-	2.47	6-M
12-M	2.78	2.78	2.72	2.75	2.75	2.75	2.68	2.61	2.57	2.52	2.49	2.44	12-M

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2025

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2025

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

Nr.	EMËRTIMI	January Janar	February Shkurt	March Mars	April Prill	May Maj	June Qershor	July Korrik	August Gusht	September Shtator	October Tetor	November Nëntor	December Dhjetor	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>64,609</b>	<b>116,887</b>	<b>181,106</b>	<b>246,841</b>	<b>306,201</b>	<b>366,080</b>	<b>433,449</b>	<b>499,060</b>	<b>562,855</b>	<b>628,193</b>	<b>688,271</b>	<b>754,608</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>1,326</b>	<b>919</b>	<b>1,267</b>	<b>1,697</b>	<b>1,916</b>	<b>2,173</b>	<b>2,946</b>	<b>3,394</b>	<b>5,386</b>	<b>5,792</b>	<b>6,405</b>	<b>7,383</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>60,761</b>	<b>111,217</b>	<b>173,244</b>	<b>235,581</b>	<b>292,366</b>	<b>349,433</b>	<b>414,011</b>	<b>475,600</b>	<b>534,654</b>	<b>595,808</b>	<b>652,989</b>	<b>716,283</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>42,638</b>	<b>77,740</b>	<b>123,393</b>	<b>163,886</b>	<b>203,426</b>	<b>242,327</b>	<b>287,089</b>	<b>331,470</b>	<b>372,331</b>	<b>413,718</b>	<b>453,213</b>	<b>496,225</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	22,020	38,614	56,617	74,351	92,764	109,091	130,307	149,939	168,237	188,516	207,841	227,261	VAT
2	Tatimi mbi Fitimin	2,965	6,402	17,392	24,479	28,472	33,237	37,093	40,712	45,279	49,005	52,716	58,547	Profit Tax
3	Akcozat	4,867	9,466	14,574	19,966	25,707	32,083	39,010	46,235	52,313	58,326	63,599	69,599	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	7,277	13,549	20,748	27,182	34,054	40,810	48,251	56,703	63,147	69,488	75,962	82,532	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,923	8,461	12,015	15,069	18,755	22,595	26,948	31,637	36,323	40,532	44,504	48,799	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	586	1,248	2,045	2,839	3,673	4,511	5,481	6,244	7,032	7,852	8,592	9,486	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,856</b>	<b>3,406</b>	<b>5,971</b>	<b>12,062</b>	<b>15,063</b>	<b>19,133</b>	<b>22,687</b>	<b>25,296</b>	<b>28,798</b>	<b>32,267</b>	<b>35,580</b>	<b>40,911</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	406	813	1,426	3,296	3,876	4,723	5,333	5,834	6,484	7,040	7,485	8,144	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	6	12	4	5	10	15	18	21	24	33	36	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,447	2,586	4,533	8,762	11,181	14,400	17,339	19,443	22,293	25,204	28,062	32,731	Local Taxes
II.3	<b>Të ardhura nga fondet speciale</b>	<b>16,267</b>	<b>30,072</b>	<b>43,881</b>	<b>59,633</b>	<b>73,877</b>	<b>87,973</b>	<b>104,235</b>	<b>118,835</b>	<b>133,525</b>	<b>149,822</b>	<b>164,196</b>	<b>179,147</b>	<b>Social Ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	14,011	25,992	37,971	51,468	63,788	76,019	89,963	102,620	115,347	129,310	141,712	154,666	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	2,200	3,962	5,712	7,889	9,735	11,532	13,779	15,648	17,535	19,791	21,662	23,543	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	56	118	198	277	353	421	493	568	643	721	822	939	Compensation income in the value of owners
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,523</b>	<b>4,730</b>	<b>6,594</b>	<b>9,564</b>	<b>11,919</b>	<b>14,454</b>	<b>16,492</b>	<b>20,066</b>	<b>22,815</b>	<b>26,593</b>	<b>28,877</b>	<b>30,941</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shoqërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,139	2,527	3,512	4,586	5,912	7,451	8,391	10,716	11,663	13,619	14,526	15,458	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	306	543	774	1,014	1,269	1,560	2,000	2,324	2,616	2,994	3,271	3,545	Utility fees
4	Të tjera	1,078	1,660	2,308	3,949	4,723	5,419	6,075	6,999	8,509	9,937	11,035	11,893	Others
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>46,480</b>	<b>93,880</b>	<b>147,361</b>	<b>208,771</b>	<b>267,144</b>	<b>332,967</b>	<b>401,886</b>	<b>458,456</b>	<b>517,249</b>	<b>579,310</b>	<b>639,153</b>	<b>801,695</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>44,555</b>	<b>90,721</b>	<b>139,103</b>	<b>193,030</b>	<b>243,494</b>	<b>299,617</b>	<b>357,292</b>	<b>407,961</b>	<b>457,614</b>	<b>511,266</b>	<b>560,985</b>	<b>653,530</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personell</b>	<b>9,987</b>	<b>20,229</b>	<b>30,444</b>	<b>40,977</b>	<b>51,541</b>	<b>62,080</b>	<b>72,835</b>	<b>83,169</b>	<b>93,358</b>	<b>103,739</b>	<b>114,354</b>	<b>125,694</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	8,552	17,351	26,101	35,144	44,201	53,232	62,337	71,104	79,857	88,729	97,771	107,361	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,425	2,847	4,272	5,730	7,186	8,647	10,102	11,539	12,910	14,334	15,766	17,282	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	10	31	71	103	154	201	397	526	590	677	817	1,052	Higher education from its own income
I.2	<b>Interesat</b>	<b>8,865</b>	<b>13,451</b>	<b>17,919</b>	<b>21,203</b>	<b>23,482</b>	<b>30,290</b>	<b>38,665</b>	<b>42,613</b>	<b>45,990</b>	<b>50,100</b>	<b>54,048</b>	<b>54,692</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	7,536	11,607	14,726	17,094	18,392	18,965	26,182	29,838	32,105	34,221	35,044	35,186	Domestic
2	Të Huaja	1,329	1,844	3,193	4,109	5,090	11,305	12,484	12,776	13,886	15,879	19,003	19,505	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>2,121</b>	<b>5,914</b>	<b>10,214</b>	<b>17,743</b>	<b>23,792</b>	<b>30,438</b>	<b>38,131</b>	<b>42,943</b>	<b>48,587</b>	<b>56,011</b>	<b>62,098</b>	<b>83,670</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveclonet</b>	<b>35</b>	<b>187</b>	<b>308</b>	<b>826</b>	<b>922</b>	<b>1,077</b>	<b>1,180</b>	<b>1,275</b>	<b>1,431</b>	<b>1,620</b>	<b>1,750</b>	<b>2,364</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>18,166</b>	<b>38,363</b>	<b>59,130</b>	<b>82,014</b>	<b>104,739</b>	<b>127,089</b>	<b>148,019</b>	<b>169,888</b>	<b>190,975</b>	<b>212,491</b>	<b>232,059</b>	<b>270,271</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	14,445	29,064	45,401	62,018	79,098	95,976	111,592	128,312	144,383	160,149	175,181	204,060	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	3,715	9,131	13,564	19,462	25,150	30,584	36,746	40,892	45,710	51,461	55,997	63,927	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	6	168	165	535	491	529	681	684	882	882	882	2,284	Owners' Compensation Fund
I.6	<b>Shpenzime për Buxhetin Vendor</b>	<b>3,944</b>	<b>9,263</b>	<b>15,575</b>	<b>22,649</b>	<b>29,252</b>	<b>36,547</b>	<b>44,194</b>	<b>51,599</b>	<b>58,711</b>	<b>66,353</b>	<b>73,342</b>	<b>87,793</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,436</b>	<b>3,314</b>	<b>5,513</b>	<b>7,617</b>	<b>9,766</b>	<b>12,096</b>	<b>14,267</b>	<b>16,474</b>	<b>18,561</b>	<b>20,953</b>	<b>23,334</b>	<b>29,046</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	55	111	168	227	279	330	382	433	506	576	628	692	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,381	3,200	5,149	7,042	8,995	10,950	12,886	14,746	16,560	18,547	20,589	25,471	Economic Aid
3	Kompensim për ish të përndjekurit politike	0	3	95	148	193	316	399	494	595	729	916	1,399	Compensation for the political persecuted
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,906</b>	<b>3,159</b>	<b>8,248</b>	<b>15,742</b>	<b>23,650</b>	<b>33,350</b>	<b>44,594</b>	<b>50,495</b>	<b>59,636</b>	<b>68,043</b>	<b>78,168</b>	<b>131,577</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi i Brendshëm	0	202	3,937	10,050	15,921	23,798	31,568	35,652	42,244	49,434	57,677	107,258	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0	31	100	103	160	210	294	401	522	618	648	865	From higher education system's own revenues
3	Financimi i Huaj	1,906	2,925	4,027	5,241	7,025	8,152	11,177	12,528	14,773	15,649	17,335	20,298	Foreign financed
IV	<b>Fondi i rindërtimit</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>183</b>	<b>347</b>	<b>543</b>	<b>1,189</b>	<b>1,855</b>	<b>1,915</b>	<b>2,096</b>	<b>2,343</b>	<b>2,508</b>	<b>3,157</b>	<b>Reconstruction fund</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>18,149</b>	<b>22,987</b>	<b>33,755</b>	<b>38,070</b>	<b>39,057</b>	<b>33,093</b>	<b>31,563</b>	<b>40,603</b>	<b>45,606</b>	<b>48,883</b>	<b>49,118</b>	<b>-47,088</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-18,149</b>	<b>-22,987</b>	<b>-33,755</b>	<b>-38,070</b>	<b>-39,057</b>	<b>-33,093</b>	<b>-31,563</b>	<b>-40,603</b>	<b>-45,606</b>	<b>-48,883</b>	<b>-49,118</b>	<b>47,088</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-14,693</b>	<b>-81,213</b>	<b>-92,432</b>	<b>-92,833</b>	<b>-92,018</b>	<b>-84,760</b>	<b>-64,738</b>	<b>-72,766</b>	<b>-77,058</b>	<b>-46,938</b>	<b>-46,165</b>	<b>38,846</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	1	226	236	238	239	240	295	296	297	298	299	301	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-5,044	-6,915	-6,535	-4,323	6,548	11,889	6,997	16,741	26,441	27,708	40,134	49,338	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-9,640	-74,525	-86,133	-88,748	-98,805	-96,889	-72,030	-89,803	-103,796	-74,944	-86,598	-10,793	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>-3,466</b>	<b>58,226</b>	<b>58,677</b>	<b>54,763</b>	<b>52,961</b>	<b>51,667</b>	<b>33,175</b>	<b>32,163</b>	<b>31,452</b>	<b>-1,945</b>	<b>-2,953</b>	<b>8,242</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	680	64,682	65,448	66,900	68,495	69,496	71,801	72,853	74,164	75,318	76,713	78,818	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndihshimi i gjendjes së arkës*	-63	476	541	19	44	-17	-30	137	506	-431	-730	-575	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-4,083	-6,932	-10,283	-15,127	-18,549	-20,784	-42,138	-44,370	-47,033	-85,117	-88,312	-90,336	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	2,972	2,972	2,972	2,972	3,543	3,815	3,815	8,285	9,377	20,335	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2025

Table of investments 2025

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>-14,683</b>	<b>-81,213</b>	<b>-92,432</b>	<b>-92,833</b>	<b>-92,018</b>	<b>-84,760</b>	<b>-64,738</b>	<b>-72,766</b>	<b>-77,058</b>	<b>-46,938</b>	<b>-46,165</b>	<b>38,846</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	80.9	353.3	273.8	243.8	235.6	256.1	205.1	179.2	169.0	96.0	94.0	82.5	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>-3,466</b>	<b>58,226</b>	<b>58,677</b>	<b>54,763</b>	<b>52,961</b>	<b>51,667</b>	<b>33,175</b>	<b>32,163</b>	<b>31,452</b>	<b>-1,945</b>	<b>-2,953</b>	<b>8,242</b>	<b>Foreign financing</b>
Në %	19.1	-253.3	-173.8	-143.8	-135.6	-156.1	-105.1	-79.2	-69.0	4.0	6.0	17.5	In %
<b>Totali</b>	<b>-18,149</b>	<b>-22,987</b>	<b>-33,755</b>	<b>-38,070</b>	<b>-39,057</b>	<b>-33,093</b>	<b>-31,563</b>	<b>-40,603</b>	<b>-45,606</b>	<b>-48,883</b>	<b>-49,118</b>	<b>47,088</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2025  
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2025

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek ( in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	Dhjetor December	
<b>TË ARDHURAT DOGANORE 2025 (CUSTOMS REVENUE)</b>													
Taksë doganore	586	1,248	2,045	2,839	3,673	4,511	5,481	6,244	7,032	7,852	8,592	9,486	Customs Duties
TVSH	10,745	22,522	35,544	48,833	62,294	75,936	91,137	104,153	117,832	131,814	144,216	158,742	V.A.T
Akcizë	4,867	9,466	14,574	19,966	25,707	32,083	39,010	46,235	52,313	58,326	63,599	69,599	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	184	406	634	786	979	1,116	1,271	1,410	1,492	1,694	1,762	1,854	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>16,383</b>	<b>33,641</b>	<b>52,797</b>	<b>72,425</b>	<b>92,653</b>	<b>113,646</b>	<b>136,898</b>	<b>158,042</b>	<b>178,669</b>	<b>199,686</b>	<b>218,169</b>	<b>239,682</b>	<b>Total</b>
<b>TË ARDHURAT TATIMORE 2025 (TAX REVENUE)</b>													
TVSH	11,275	16,092	21,073	25,518	30,470	33,155	39,170	45,786	50,405	56,702	63,624	68,519	V.A.T
